



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT – VENDIM

Nr. datë . 2025

PËR
“PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË NJË OBJEKTI BANIMI ME BANESA SOCIALE NË
TRUALLIN NË PRONËSI TË BASHKISË”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pikat 1, nënpikat 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, kreu II nenit 4, pika a dhe dh, kreu III neni 11, pika a, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit dhe Njësive të Qeverisjes Vendore”; VKM nr. 384 ,datë12.06.2019 të Këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përfitim nga programet e strehimit social”, VKM Nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” Vendimi nr.670, datë 10.10.2018 të Këshillit të Ministrave , “Për miratimin e dokumentit të politikave kombëtare për strehimin social 2018-2025”, sipas Termave të Referencës për Projektet e Investimit që do të Financohen nga Buxheti i Shtetit në vitet 2025-2026, Drejtoria e Shërbimit Social, zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____/____/2025.

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit i një objekti me banesa sociale në truall në pronësi të Bashkisë Kolonjë i vendosur në adresë:Në krahun jugor të rrugës “Dhori Qirjazi”.
2. Objekti do të ketë si qëllim streha sociale për familjet pastreha, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj.
3. Objekti do të ndërtohet në përputhje me planin urbanistik të miratuar dhe standartet teknike për banesë sociale, duke garantuar dhe akses për personat me aftësi të kufizuar.
4. Numri total i apartamentve të projektit është 30 apartamente 2 pallate 5 katëshe,të ndara në njësi të tipologjive të ndryshme(gasoniere,apartament 1+1,2+1,etj)

5. Trualli ku do të ndërtohet objekti është në pronësi të Bashkisë Kolonjë dhe ka sipërfaqen prej 3,364 m², e regjistruar në ZRPP me Zonën Kadastrale 1594 Nr.Pasurie truall 8/79, volum 14, faqe 232, qyteti Ersekë .
6. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak.
7. Për zbatimin e tij ngarkohet administrata e Bashkisë.

Konceptoi:

Specialisti: Artiola Dajlani



Drejtore i Shërbimit Social
Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
Elfanada DAKE



KRYETARI I BASHKISË
Erion ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 340 Prot.

Datë 21.01.2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. _____ Datë ____/____/2025

PËR
“PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË NJË OBJEKTI BANIMI ME BANESA SOCIALE NË
TRUALLIN NË PRONËSI TË BASHKISË”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pikat 1, nënpikat 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, kreu II nenit 4, pika a dhe dh, kreu III neni 11, pika a, neni 15, 16 dhe 20 të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit dhe Njësive të Qeverisjes Vendore”; VKM nr. 384 ,datë12.06.2019 të Këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin nga programet e strehimit social”, VKM Nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” Vendimi nr.670, datë 10.10.2018 të Këshillit të Ministrave , “Për miratimin e dokumentit të politikave kombëtare për strehimin social 2018-2025”, sipas Termave të Referencës për Projektet e Investimit që do të Financohen nga Buxheti i Shtetit në vitet 2025-2026, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve paraqet për miratim projekt-vendimin:

Për projektin:– Ndërtimit të ri në truall në pronësi të Njesisë së Vetqeverisjes Vendore.

Pas verifikimit nga ana e Administratorëve Shoqërorë, të familjeve që jetojnë në territorin e bashkisë Kolonjë, pas shpalljes së lajmërimit, me dokumentacionin dhe kriteret përfituese, për përfitimin e statusit të pastrehë, pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, kanë paraqitur dokumentacion 23 familje, si familje të cilat nuk kanë objekt në pronësi, bashkë me dokumentacionin e kërkuar.

Nga këto familje, 8 familje kanë paraqitur vërtetim page, që janë të punësuar pjesa më e madhe në institucione shtetërore dhe 4 familje përfituese nga programet e mbrojtjes sociale, ndihmë ekonomike dhe aftësi e kufizuar.

Numri i familjeve të pastreha, duke parë kërkesat e paraqitura pranë Institucionit tonë, është i lartë, por nuk janë plotësuar me dokumentacion përkatës.

Për këtë arsye, Drejtoria e Shërbimit Social, do paraqesë në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, format aplikimi për ndërtimin e një pallati banimi, për të përfituar familjet e pastreha, kundrejt pagesës së vendosur, duke parë se kërkuessit janë me të ardhura të qëndrueshme mujore, sipas Termave të Referencës për Projektet e Investimit që do të Financohen nga Buxheti i Shtetit në vitet 2025-2026, për programin Banesa sociale me qira të cilat mund të sigurohen nëpërmjet: ndërtimit të ri në truall në pronësi të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore.

Konceptoi:

Specialisti: Artiola Dajlani



Drejtore i Shërbimit Social
Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
Elfanada DAK



KRYETARI I BASHKISË
Erion ISAI

Në mungesë dhe me urdhër

Nënkryetar
Petro Risto

